



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT
të mbledhjes së pestë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më
26.4.2012, e cila filloi në orën 11:00.

Në mbledhje morën pjesë: Avdullah Hoti, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, kryesues i Kuvendit, këshilltarët: Hazir Borovci, Shaip Hajrizi, Bekim Gashi, Hetem Kupina, Vjollca Dibra - Ibrahim, Rrahman Ismajli, Rexhep Mustafa, Avdush Dobratiqi, Premtina Rakovica, Muhamet Nura, Vjollca Rizani, Ajnishahe Azemi, Mustafë Krasniqi, Sarandë Sadriu, Arta Krasniqi, Luan Jusufi, Sali Krasniqi, Tefik Mehmeti, Fetah Salihu, Naime Osmani, Bajram Selimaj, Shefki Uka, Musli Mehaj, Agim Krasniqi, Flamur Shala, Nexhmije Berisha, Aziz Pacolli, Remzi Pacolli, Milazim Vitia, Naim Makolli, Donika Surdulli, Nerxhivane Vitia, Sofije Klllokoqi, Valon Hiseni, Liridon Restelica, Afërdita Veliu, Besa Halimi – Zagragja, Lumnie Rama, Shefqet Sylejmani, Astrit Hasani, Meliza Haradinaj, Mejreme Berisha, Shefki Gashi, Besa Rafuna, Feti Mejdiu, Kimet Zeqa dhe Sadri Ramabaja.

Munguan: Shemsi Veseli, Skënder Reçica dhe Engin Beyoglu, (me leje).

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, të OSBE – së dhe të mjeteve të informimit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Sami Hamiti, kryesues i Kuvendit.

Fillimisht **kryesuesi** hapi diskutimin rreth rendit të ditës.

Liridon Restelica tha se është dashtë të jetë si pikë e rendit të ditës një informatë rreth arkëtimit të të hyrave dhe shpenzimeve të mjeteve të buxhetit për tremujorin e parë të këtij viti.

Kryesuesi tha se në pikën “*të ndryshme*”, do të prezantojnë përfaqësuesit e Kryqit të Kuq, ku do të informohemi kryesisht rreth veprimtarisë së Kryqit të Kuq, dhe nga z. Hetem Kupina, që do ta kemi një informatë rreth punës së Komisioni për zgjedhjet nëpër bashkësitë lokale të Komunës së Prishtinës.

U konstatua se njëzëri u miratua ky

REND DITE:

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së tretë dhe të katërt të Kuvendit;
2. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të shkollës fillore dhe të mesme të muzikës dhe baletit "Prenk Jakova" në Prishtinë;
3. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të shkollës fillore dhe çerdhes së fëmijëve në lagjen "Kodra e Trimave 1";
4. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për të hyrat vetanake të institucioneve arsimore;
5. Propozimvendimi për garanci të kthimit të kredisë;
6. Pyetje dhe përgjigje;
7. Të ndryshme.

Pika e parë

Sadri Ramabaja bëri vërejtje në ekstrakt të procesverbalit të mbledhjes së tretë, duke thënë se me rastin e diskutimit rreth NPK "Trafiku Urban", konkretisht rreth mbështetjes financiare për këtë ndërmarrje, nga ajo që është theksuar në ekstrakt, rezulton se sikur kjo mbështetje ka qenë si mbështetje nga Lëvizja Vetëvendosje. Do të ishte mirë që, për herët tjera, emir i Lëvizjes Vetëvendosje të futet në kllapa (LV) dhe nënkuptohet pastaj që ka qenë fjala për një mbështetje në emër të këtij Kuvendi, jo thjeshtë në emër të LV-së.

Lidhur me ekstraktin e mbledhjes së katërt - të fundit, e potencoi edhe njëherë se do të ishte mirë të precizohet kush voton kundër dhe kush abstenon. Nuk është vepruar në secilën pikë, para së gjithash, insistoj që kjo të bëhet sidomos te deklarata, me të cilën ky Kuvend u identifikua në mbledhjen e kaluar.

Me vërejtjen e dhënë, njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tretë dhe ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së katërt.

Pika e dytë:

Lidhur me këtë pikë, kryesuesi hapi diskutimin.

Mustafë Krasniqi tha se GP i LDK-së e ka shqyrtuar dhe analizuar këtë propozimvendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të shkollës fillore dhe të mesme të muzikës dhe baletit "Prenk Jakova", të cilin e përkrahim dhe kërkojmë që familjeve të strehuara në atë hapësirë, t'iu zgjidhet çështja e strehimit.

Aziz Pacolli tha se edhe ne si GP i AKR-së, e kemi analizuar dhe e kemi shqyrtuar propozimvendimin për caktimin e lokacionit, andaj dhe kishim kërkuar që të jetë lokacioni i fundit që nuk do të ndryshojë më, ku do të

ndërtohet objekti i shkollës, e të mos vije deri te ndërrimi i lokacionit, siç ka ndodhur deri më tani.

Liridon Restelica tha se edhe GP i PDK-së e ka shqyrtuar dhe e ka analizuar mirë këtë propozimvendim, dhe e përkrah plotësisht. Gjithashtu e përkrah parafolësin, z. Mustafën, për gjetjen e një alternative tjetër për banorët që janë aty në atë lokacion.

Lidhur me çështjen e familjeve që janë të vendosura në atë lokacion, kryesuesi tha se ata nuk kanë dokumentacion për ato objekte, andaj është mirë që Kuvendi ta marrë parasysh mundësinë e gjetjes së ndonjë zgjidhjeje, d.m.th. nuk është lokacion që me vendim Komuna e ka dhënë dhe ka obligime drejtpërdrejt për ta.

Shefqet Sylejmani, në emër të GP të AAK-së, përkrahu propozimin për lokacionin e caktuar, që është në përputhje të plotë me synimet dhe angazhimet e grupit tonë parlamentar, që shkollat të shpërndahen suksesivisht në territorin e komunës së Prishtinës, në mënyrë që të mos e kemi grumbullimin e shkollave në një vend, andaj dhe konsiderojmë se kjo është në frymën e atij zhvillimit harmonik, që tërë kohën e kemi potencua ne si GP.

Besa Rafuna, në emër të GP të LDD-së, përkrahu këtë propozimvendim.

Feti Mejdiu tha se edhe ne si GP e përkrahim gjithashtu, me shpresën dhe urimin që të jepet një afat i fillimit dhe mbarimit të ndërtimit të shkollës.

Njëzëri u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të shkollës fillore dhe të mesme të muzikës dhe baletit "Prenk Jakova" në Prishtinë.

Pika e tretë

Njëzëri u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të shkollës fillore dhe çerdhes së fëmijëve në lagjen "Kodra e Trimave 1".

Pika e katërt

Lidhur me Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për të hyrat vetanake të institucioneve arsimore, sqarime të nevojshme dha Agim Salihu, duke shtuar se me hyrjen në fuqi të Udhëzimit administrativ nr. 11/2011, të datës 30.12.2011, për participimin e vijuesve të arsimit dhe arsimit për të rritur, jemi të obliguar që të bëjmë ndryshimin e nenit 7 të kësaj rregulloreje.

Flamur Shala tha se GP i LDK-së e ka shqyrtuar dhe analizuar këtë propozimvendim. Vërejtjet e GP janë se çmimet për pozicione të caktuara të pagesave, për regjistrimin e vijuesve të arsimit për të rritur janë më të larta, këto që i ka sjellë Ministria e Arsimit përmes Udhëzimit administrativ. Por, meqë është dashur që të harmonizohet Rregullorja që e ka sjellë ky Kuvend, përkatësisht neni 7 i saj, me këto që i gjejmë në Udhëzimin administrativ, ne e përkrahim miratimin e këtij propozimvendimi.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se meqë ky propozim vjen pas miratimit të Ligjit për pagesa prej Ministrisë, faktikisht ndryshimi bëhet në bazë të ligjit, edhe në përkrahim miratimit e këtij propozimvendimi.

Liridon Restelica, në emër të GP të PDK-së, tha se, pasi që këto ndryshime janë në bazë të ligjit, këtë propozimvendim e përkrahim për miratim.

Mejreme Berisha, në emër të GP të AAK-së, tha se mbase ky propozimvendim vjen i gatshëm, në pajtohemi që kjo të kalojë.

Shefki Gashi, në emër të GP të LDD-së, tha se në këtë propozimvendim është dashtë që të definohet për cilin nivel të shkollimit duhet të bëhen këto pagesa, megjithatë e përkrahim këtë propozimvendim për miratim.

Feti Mejdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, duke respektuar punën që e ka bërë komisioni, tha se do ta përkrahim, por kemi një sugjerim. Mendimi ynë është se për shkollim çfarëdo qoftë, më duken të larta këto çmime. Thirren në ligje, por edhe ligjet në qoftë se i kemi miratuar me nguti, nuk kemi menduar mirë sa duhet për kualifikim për shkollimin e këtyre njerëzve, është mirë me e rishqyrtuar edhe ata. Nuk është ndoshta kompetencë e jona, por ne kemi të drejtë të iu sugjerojmë. Të larta më duken shumë 100, 50, por edhe 30 euro.

Me këtë sugjerim, e përkrahim dhe do ta votojmë për miratim këtë propozimvendim.

Sadri Ramabaja (LV) tha se duket që ky presioni që vjen prej lart vazhdimisht, pastaj i detyron njerëzit që të rezonojnë në përpunje me presionet qoftë nga lartë, qoftë nga zyrat e huaja etj. Në qoftë se kemi parasysh gjendjen sociale që ka një kategori e njerëzve tanë, në rrethana të luftës ose në rrethana të jashtëzakonshme, nuk kanë arritur të kryejnë shkollimin e mesëm, dhe sot kanë dëshirë që ta kryejnë, ky çmim është shumë i lartë. Kisha sugjeruar që të shikohet dhe, në kuadër të këtij harmonizimi, të shkohet në minimumin e mundshëm. Kjo është arsyeja pse unë nuk do ta kisha votuar me kënaqësi, sidomos për çmimin 100 dhe 50 euro.

Me shumicë absolute votash, një abstenim (Sadri Ramabaja), u miratua Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për të hyrat vetanake të institucioneve arsimore.

Pika e pestë

Lidhur me Propozimvendimin për garanci të kthimit të kredisë, informoi Agim Salihu, duke thënë se në bazë të kërkesës që e ka bërë ngrohtorja e qytetit "Termokos" SHA për realizimin e projektit, është propozuar shuma, e cila në vendim është përcaktuar 5 milion, si garanci e kthimit të kredisë. Në bazë të këtij vendimi, që bazën e ka në Ligjin për borxhet publike, iu mundëson komunave që në raste të caktuara, të japin garanci për personin e tretë, për përmbushjen e obligimeve që kanë interes publik.

Tefik Mehmeti tha se në bazë të arsyetimit që është sqaruar mjaft mirë dhe në detaje si për projektin, ashtu edhe për të gjitha kushtet tjera, afati i kthimit të kredisë mendoj se është shumë i favorshëm, meqë kjo ndërmarrje është në gjendje mjaft të vështirë, ose do të përmirësohet deri atëherë, ose vështirë që do të përmirësohet ndonjëherë. Si GP i LDK-së e përkrahim miratimin e këtij propozimvendimi.

Aziz Pacolli, në emër të GP i AKR-së, tha se edhe ne japim pëlqimin për garanci të kredisë.

Liridon Restelica tha se GP i PDK-së e ka shqyrtuar me vëmendje këtë dokument, dhe ka vërejtur se dhënia e kësaj garancie është në përputhje me të gjitha normat dhe ligjet që i posedon Republika e Kosovës, andaj e përkrahim plotësisht.

Shefqet Sylejmani tha se, si GP i AAK-së, jemi angazhuar edhe më herët për ndihmën që Komuna duhet t'ua ofrojë ndërmarrjeve të veta, prandaj e përkrahim këtë dhe urojmë që koogjenerimi përfundimisht të realizohet, të realizohen edhe qëllimet e Termokosit karshi qytetarëve të Prishtinës.

Shefki Gashi, në emër të GP të LDD-së, ngriti shqetësim rreth kthimit të kësaj kredie, duke shtuar se kjo që ceket në këtë vendim nuk është në rregull, sepse në perspektivë nuk shoh që ky borxh mund të kthehet nga Termokosi. Mendimi im është që këtë kredi Komuna ta kryejë vetë, sepse nuk ka asnjë mundësi me e paguar Termokosi.

Feti Mejdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se do t'i bashkohemi mendimit që shumica e përkrahën, të vetëdijshëm që ata që e kanë hartuar si duhet, e kanë edhe përgjegjësinë më të madhe sesa ne që e miratojmë tash.

Prandaj, ne e përkrahim në parim këtë vendim.

Sadri Ramabaja (LV), meqë kemi të bëjmë me një formë të re të komunikimit, respektivisht të veprimtimit me ndërmarrjet publike, e shfrytëzoj rastin që të potencoj edhe njëherë rolin dhe nevojën e ngritjes së një banke komunale. Me një formë të tillë do të zgjidheshin shumë dilema, sepse format e dhënies pa garanci, besueshmërisë së kthimit etj. sigurisht që do të sjellin telashe në të ardhmen dhe do të detyrohemi ta marrim ndonjë vendim tjetër, që t'ia falim krejt. Po të iniciohej ngritja e një banke komunale, ashtu si e kanë shumica e qendrave evropiane bankën e tyre, unë ju premtoj publikisht se do t'ua vë në pozicion një projekt fizibiliteti të plotë.

Njëzëri u miratua Vendimi për garanci të kthimit të kredisë.

Pika e gjashtë

Pyetje dhe përgjigje

Kimet Zeqa, kërkesë për Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale

Kam një ankesë apo kërkesë, ta quaj ashtu, prej një koleges, e cila punon në Shtëpinë e Shëndetit në QKMF. Ankesa për lëshimin e vendimit për punë si asistente në QKMF.

Pasi që pas një viti maltretim për t'u kthyer në punë si Koordinatorë në Sistemin informativ të shëndetësisë, meqenëse e posedoj këtë aftësi, prapë nuk gjejnë mirëkuptim, sepse më lëshohet Vendimi si asistente në QKMF, ku punët të kryhen nëpër lokacione ku ka nevojë, që unë këtë punë nuk mund ta bëjë si e verbër, paraqesë këtë ankesë.

I kam bërë njoftim drejtorit të Shtëpisë së Shëndetit për aftësitë e mia që posedoj, por më ka refuzuar.

Shpresoj se do të has në mirëkuptim, dhe maltretimet e mia do të marrin fund, sepse nuk kuptoj në çfarë bazash merr vendim drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale Shëndetësore, të më lëshojë vendim si asistente, që nuk mund të punoj, e unë kërkoj të punoj.

Znj. Behare ka punuar këtu para luftës 22 vjet, kurse pas luftës gjendja e saj u keqësua, është punëtore e zellshme, çdo mëngjes vjen në orën 7:00 në punë, ku e përcjell vëllai, por as kompjuter nuk ka, është vajza e profesorit të fizikës Zekë Hagjosaj.

Për këtë rast është i njoftuar edhe dr. **Valboni**, dhe mendoj që duhet dhe mundet të gjendet një zgjidhje pa gjykatë, për ata edhe janë menaxherët, drejtori komunal për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Lidhur me kërkesën e znj. **Kimet Zeqa, Valbon Krasniqi** tha se për rastin në fjalë jemi në dijeni dhe se është mirë që të informohet Kuvendi sepse për të më herët ka pas edhe një emision në televizion. Unë punëtoren e kam pritur në zyrën time dhe kam pas vullnetin që t'i ndihmojë në suaza ligjore. Punëtorja në fjalë ka humbur të parit deri sa ka qenë në punë dhe ka shkuar për shërim jashtë dhe, në ndërkohë, pas trajtimeve, shërimit jashtë vendit është kthyer.

Kur është kthyer, ka bërë një ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Realizimin e të Drejtave të Punëtorëve Civilë, dhe ai këshill pati rekomanduar që të kthehet në vendin e punës. Ne duke u bazuar në atë vendim të Këshillit, me gjithë dëshirë, sepse është punëtore e cila e ka humbur të parit dhe na vjen keq që i ka ndodhur ajo, ne e kemi kthyer në vendin e punës. Për shkak të humbjes së të parit, ajo nuk mund të jetë koordinatorë apo menaxhere, apo shefe e një sistemi shumë të rëndësishëm, por e kemi sistemuar në vendin e punës si asistente.

Liridon Restelica, pyetje për Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale

- A është funksionale mbikëqyrja e drejtpërdrejtë e qendrave të mjekësisë familjare, duke pasur parasysh papastërtinë, sjelljen e nëpunësve në raport me qytetarët ose me pacientë edhe mosrespektimi i orarit të punës?

Lidhur me pyetjen e shtruar nga z. Restelica, **Valbon Krasniqi** tha se sa i përket mbikëqyrjes funksionale menaxheriale të drejtpërdrejtë të QMF-së,

ajo ekziston dhe ekziston në baza të përditshme, duke përfshirë funksionimin që nga çështjet logjistike, po ashtu edhe punën kualitative.

Sa i përket pastërtisë në kuadër të QKMF-së, janë shërbimet e mbajtjes së pastërtisë në objektet e institucioneve shëndetësore, së bashku me çështjen e sigurisë, që mbajnë kompanitë private. Megjithatë, organet mbikëqyrëse mbikëqyrin në mënyrë të rregullt dhe çdo herë, sa herë kanë vërejtje, ato i bëjnë me shkrim dhe të gjitha janë të dokumentuara.

Shaip Hajrizi, pyetje për Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale

- Pse është ndërprerë rruga "Ibrahim Fehmiu", arsyet pse është ndërprerë dhe kur pritet të fillojë? Lidhur me këtë rrugë do të shtojë edhe diçka tjetër.

Janë disa banorë që e lëshojnë vendin e vet për trotuar, kurse janë disa të tjerë që nuk e lëshojnë për trotuar as vendin e Komunës, të cilin e kanë uzurpuar. Nëse Komuna e vlerëson që është fjala për pronë komunale, ata banorë nuk ka nevojë të pyeten fare për zgjerimin e rrugës, sepse aty nuk janë në pyetje shtëpitë, por disa mure.

- Çështja tjetër ka të bëjë me rrugën "Vëllezërit Fazliu", ku kërkohet të qitet një pengesë, që unë e kam cekë edhe më herët, e di edhe përgjigja më është dhënë, mirëpo po ju lus edhe njëherë që në atë kthesë të vendoset një pengesë, me qëllim të zvogëlimit të shpejtësisë, me qëllim të parandalimit të ndonjë aksidenti të mundshëm.

- Antena e IPKO-s që ka qenë e vendosur në objektin e shkollës fillore "Asim Vokshi" është hequr nga aty, mirëpo është vendosur para shkolle, për të cilën prindërit mendojnë që më rrezik është tash për fëmijë ku është vendosur sesa ku ka qenë më parë. Prandaj, është kërkesë e prindërve që ajo të hiqet nga aj vend.

-Sa i përket shkollës së re dhe çerdhes së re, jemi jashtëzakonisht të kënaqur dhe vetëm e përshëndesim Kryetarin dhe gjithë komunën. Kjo ka qenë kërkesë e jona dhe ky premtim i Kryetarit po realizohet, por për afërsisht, nëse ka mundësi, drejtori i Arsimit me na dhënë përgjigje se kur pritet për afërsisht të fillojë ndërtimi i saj.

- A ka mundësi të ndërtohet një çerdhe, , te shkolla fillore "Ilmi Rakovica", të cilën ne e kemi kërkuar, sepse janë dy parcela komunale dhe kemi konstatuar se aty ka mundësi të ndërtohet ajo?

Lidhur me çështje e ngritur nga z. Hajrizi, rreth përfundimit, gjegjësisht ndërprerjes së rrugës "Ibrahim Fehmiu", **Ridvan Shahini** tha se sipas shënimeve që kemi, më se 36 objekte, mure dhe objekte ndihmëse gjenden në pronë shoqërore. Përmes Bashkësisë lokale kemi dërguar shkresën dhe presim që të gjithë banorët të vijnë dhe të tregojnë se cili dhe sa metra ka uzurpuar tokë shoqërore.

Për çështjen e antenës së telefonisë mobile IPKO, **Agim Gashi** tha se as herën e parë, as tash, pronari i antenës nuk ka pas pëlqimin e ndikimit në mjedis, d.m.th ka qenë pa leje. Prandaj, unë mendoj se Inspekcioni

menjëherë mund të ndërhyjë dhe ta zhvendos, sepse askush nuk mund të montojë, apo të bëjë një instalim të tillë pa pëlqimin e ndikimit në mjedis.

Lidhur me ndërtimin e shkollës fillore, **Halim Halimi** tha se lokacioni i propozuar është kontest pronësor, dhe me rastin e zgjidhjes së këtij problemi do të fillojë ndërtimi i shkollës.

Sa i përket çerdhes së fëmijëve, do ta shqyrtojmë atë mundësi të caktimit të lokacionit, por nuk është paraparë me buxhet të ndërtohet ajo çerdhe për këtë vit.

Lumnije Rama parashtroi kërkesë për Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale

- Rruga "Shaip Kamberi", e cila është njëkaheshe te lagjja "Velania", është në gjendje të mjerueshme. Kërkoj që të bëhet sanimi i gropave dhe çka është e mundur të bëhet. Këtë e dinë ata që janë kompetent për këtë punë.

Tefik Mehmeti parashtroi kërkesë për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim

Në emër të qytetarëve të lagjes "Arbëria" dhe banorëve rreth ish- Fabrikës së tjegullave lidhur me vijimin e punëve në mbulimin e gropës në mes varrezave dhe ish-Fabrikës. Punët kanë filluar vitin e kaluar, por, për arsye të ndryshme janë ndërprerë, andaj këtë vit qytetarët e pandërgjegjshëm kanë filluar me të madhe hedhjen e mbeturinave të ndryshme, çka do të thotë se shumë shpejt do të vjen gjendja siç ishte më herët, ndoshta edhe më keq, nëse lihet kështu siç është, pa ndërmarrë ndonjë hap konkret në këtë drejtim. Me ardhjen e stinës së nxehtë, këtu do të vije edhe deri te ndezja e mbeturinave, që për pasojat zinxhirore besoj se nuk do koment si për ambientin, ashtu edhe për qytetarët e kësaj pjese, e besoj edhe për gjithë Prishtinën, andaj dhe shtrohet pyetja se çka jeni duke bërë në këtë drejtim.

Kërkesë për Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale

Kërkesë për sqarim lidhur me rregullimin e rrugës Viti e Marecit – Bullaj.

Më 21.4.2012, me kërkesën e fshatarëve, isha për vizitë në fshatin Marec, konkretisht rrugën Viti – Bullaj, e cila është në ndërtim e sipër. Atë ditë në vendpunishte ishin katër punëtorë, me tri makineri: një ekskavator, një ngarkues dhe një kamion. Në bazë të asaj çka pashë unë, ishin duke shkuar shumë ngadalë. Pyetja e fshatarëve dhe e imja është se kur do të përfundojë ndërtimi i kësaj rruge, pra deri kur është afati ligjor i përfundimit të saj.

Pyetja tjetër, tek ura e fundit, pra në Bullaj, nga ana e majtë, nuk është paraparë sipas fshatarëve kyçja në lumin e fshatit, e përroskës që vjen nga kjo anë, konkretisht nga veriu, që me rastin e shirave dhe dimrit, ka shumë ujë që mund ta dëmtoj rrugën në formën si është mbetur, andaj dhe duhet punë shtesë për rregullimin e saj me gypa të profileve të mëdha.

A janë në projekt edhe këto rregullime?

Naime Osmani, pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Banorët e fshatit Besi kanë në plan të organizojnë një aksion për pastrimin e disa pjesëve të fshatit nga mbeturinat, të cilat hidhen nga personat të

pjesëve të tjera në hapësirat më të bukura të fshatit, pikërisht anash rrugës Besi - Rimanishtë. Nga kjo drejtori kërkojmë që në ditën e këtij aksioni, të na ndihmojë me mjete teknike (ndonjë ekskavator), si dhe të na furnizojë me një numër të konsiderueshëm të pishave që t'i mbjellim në atë hapësirë. Aksioni do të organizohet në të dy të dielat e para të muajit maj, andaj kërkoj që një komision të dalë dhe t'i verifikojë më parë ato pjesë ku janë duke u hedhur mbeturinat.

Para disa muajve më pare për këtë drejtori kamë bërë një kërkesë lidhur me ndriçimin e rrugëve për Lagjen I dhe Lagjen e Bllacajve të Basisë. Për këto kërkesa pres përgjigje në kohën më të shkurtër të mundshme.

Lidhur me kërkesën e znj. Osmani, **Agim Gashi** tha se nuk e shoh të arsyeshme që të ngrihet në Kuvend kjo, për shkak se nëse ju keni drejtuar Drejtorisë, përgjigjen e keni të gatshme dhe ne i bashkohemi aksionit tuaj dhe ju përkrahim në çdo aksion që ju ndërmerrni në pastrimin e hapësirës.

Sa i përket ndriçimit, do të jetë pjesë e projektit, i cili është në procedurë të tenderimit për vitin 2012.

Mejreme Berisha, pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtje she Shpëtim

Operatorët privatë të trafikut urban në kryeqytetin tonë nuk e respektojnë itinerarin e udhëtimeve dhe ndërrojnë drejtimet e rrugëve. Rast konkret është vija e operatorit nr. 9, "Profiti", për Mat I, cili i len qytetarët te Banosat e Bardha dhe në anën tjetër i zë linjën 4 - shit të rregullt. Për këtë kërkesë kërkoj përgjigje me shkrim.

Është e pesta herë që e kamë shtruar këtë pyetje, pra dhe në mbledhjen e fundit, ku kam kërkuar që për rrugën "Dëshmorët e Marecit", në kthinat që dalin në rrugën "Isa Kastrati", a mund të dal komisioni, t'i verifikojë ato dhe, mundësisht, ato rrugë - kthina t'i kthejë njëkaheshe.

Pyetje për Drejtorinë e Arsimit

Kur do të fillojë punën biblioteka e gjimnazit "Xhevdet Doda" dhe kur do të plotësohet me kuadër, si dhe kur do të përfundojë ndërtimi i sallës sportive, ku punët rreth këtij projekti kanë nisur muaj më parë?

Halim Halimi tha se bibliotekës së gjimnazit, edhe shumë bibliotekave tjera, para fillimit të vitit shkollor në shtator, për shkak të buxhetit, nuk do të mund t'i plotësojmë vendet e punës. Rreth punëve të sallës sportive, punëkryesi është treguar shumë i pandërgjegjshëm, po zvarritë punët, dhe jemi të mendimit që t'i ndërpresim kontratën, dhe për këtë çështje do të ndërmarrim masa.

Hetem Kupina, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale.

Qytetarët e fshatit Sinidoll, një paralagje e qytetit, më saktë 900 m. prej vendit ku e keni shtrirë dorën e investimit, po pyesin edhe po thonë kemi mësuar në shkollë dikur se njeriu e ka prejardhjen e prej majmunit. Prej kohës së majmunave e deri në momentin kur po i interpretoj fjalët e tyre,

deri më sot asnjë investim nga Kuvendi komunal i Prishtinës nuk është bërë në atë lagje.

Po pyesin se çfarë mëkati kanë bërë ata njerëz?!

Ju lutem, përgjigjen na jepni me shkrim.

Kryesuesi edhe kësaj radhe kërkoi nga drejtorët e drejtorive që për pyetjet e parashtruara nga këshilltarët e Kuvendit, përgjigjet të jenë të sakta dhe të kthehen me kohë.

Pika e shtatë **Të ndryshme**

Feride Hyseni, sekretare e përgjithshme e Kyqit të Kuq të Kosovës, së bashku me Zekije Muriqin, Rajmonda Musliun dhe Hasan Mehmeti, prezantuan aktivitetin dhe paraqitën misionin që ka kjo organizatë. Me këtë prezantim të pranishmit fillimisht u njohën rreth themelimit të kësaj organizate, qëllimit, misionit dhe programit që ka kjo organizatë humanitare në tërë botën.

Hetem Kupina i njoftoi të pranishmit për zgjedhjen e këshillave nëpër bashkësi lokale, duke shtuar se Komuna e Prishtinës i ka 33 bashkësi lokale, 13 në fshatra dhe 20 në qytet.

Gjatë punës, Komisioni në radhë të parë i ka njoftuar të pranishmit në tubime me dispozitat e përgjithshme të parapara me Rregullore për realizimin e zgjedhjeve, në pajtim me Statutin e Komunës së Prishtinës. I kemi njoftuar rreth mënyrës së konstituimit të këshillave dhe për numrin e anëtarëve sa duhet të jenë këshillat, për mënyrën e votimit të fshehtë apo të hapët etj.

Gjatë punës Komisioni ka përjetuar çaste të mira bashkëpunimi me qytetarët, duke mos i lënë pa i përmendur edhe disa pengesa të vogla, por të tejkaluara, por megjithatë besojmë se zgjedhjet e këshillave dhe të kryesive të këshillave janë bërë në mënyrën më të mirë të mundshme.

Për 33 bashkësitë lokale, prezantoi emrat e kryetarëve të këshillave të këtyre bashkësive.

Naim Makolli shtroi pyetjen se prej këtyre kryetarëve të BL, sa janë të rizgjedhur dhe sa janë të zgjedhur për herë të parë, dhe nëse tani nuk ka përgjigje, kërkoi nga Komisioni që për mbledhjen e radhës të jepet përgjigje.

Meliza Haradinaj kërkoi nga Komisioni përkatës që të dërgohen emrat dhe bashkësitë përkatëse për të cilat janë zgjedhur personat.

Mbledhja mbaroi në orën 14:30.

PROCESMBAJTËSI
Zijadin Gashi

KRYESUESI I KUVENDIT
Sami Hamiti, ecc.i dipl.